

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Company**  
**Trepça Deoničarsko Društvo**

Nr. 5664 Data 18.06.2026  
Mitrovica Mitrovica



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 dhe nenit 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., nenit 22 paragrafi 3 dhe 4 i Statutit të Trepça Sh.A., Trepça Sh.A., me datë 18.06.2026 publikon këtë:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

<b>Titulli i pozitës së punës:</b>	Punëtor në Terminal Doganor
<b>Koeficienti/Paga:</b>	450 € bruto
<b>Nr. i kërkuar:</b>	5
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Në kohë të pacaktuar, periudha provuese 6 muaj
<b>Data e njoftimit:</b>	18.06.2026
<b>Afati për aplikim:</b>	19.06.2026 – 03.07.2026
<b>Institucioni:</b>	Ndërmarrja “Trepça Sh.A.”
<b>Njësia Biznesore:</b>	Menaxhment
<b>Vendi i punës:</b>	Terminal Doganor - PIM

## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Sigurojnë monitorimin e terminalit dhe punëve në terminal sipas kërkesave të doganës dhe zyrtarëve përgjegjës të doganës dhe të institucioneve qeveritare;
- T'u përmbahet me përpikëri rregullores rreth punëve të përditshme të terminalit;
- Të jetë vigjilent në mbrojtjen e pasurisë dhe personelit të Trepça Sh.A. gjatë tërë kohës në detyrë;
- Të faturoj dhe arkëtoj taksat për hyrje dhe dalje në terminal;
- Të lehtësojnë dhe monitorojnë lëvizjen e maunave dhe makinave në terminal;
- Të jetë i kujdesshëm dhe të ketë vetëiniciativë në organizimin e pengimit të çfarëdo rreziku që mund t'i kanoset terminalit dhe personelit të Trepça Sh.A.;
- Të raportojë menjëherë për rastet të cilat paraqesin rrezik eventual ose tentime e veprimeve të pa autorizuara të futjes në objekt etj. duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës;

### 1. Përgjegjësi të tjera të natyrës operative

- Të realizojë ngarkim/shkarkimin e mallrave në terminal sipas kërkesave të zyrtarëve doganorë, duke asistuar në procesin e kontrollit dhe verifikimit të mallrave.

## 2. Kriteret e përgjithshme

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara me ligj.

### **3. Kriteret e veçanta**

---

- Diploma e shkollës së mesme;
- Duhet të ketë së paku 1 vite përvojë pune.

### **4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre**

---

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për veprë penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

### **5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve**

---

- a. Testimi me shkrim- 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

### **6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët**

---

- Përmes ueb faqes së ndërmartjes “Trepça Sh.A.” në linkun <https://trepcasha.com/> , tek kategoria Shpallje.

### **7. Mënyra e aplikimit**

---

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.- Parku Indurstial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

## 8. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

**Sqarim:** Paga minimale përcaktohet sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.10/273 të datës 31.10.2025.

